



## DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYRA E KURRIKULES & VLERESIMIT

440 North Broad Street, Suite 251

Philadelphia, PA 19130

Donna Runner  
E ngarkuar si Zëvendës Kryetare

Tel: 215-400-4210  
Faks: 215-400-4212

Prindërve/Kujdestarëve të Nxënësve Aktualë të klasës së 9<sup>të</sup>:

Departmenti i Edukimit të Pensilvanisë ka futur Provimet e reja Keystone (Keystone Exams) për të zëvendësuar Sistemin e Vlerësimit të Shkollave të Pensilvanisë (PSSA) (Pennsylvania System of School Assessment) për klasën e 11. Provimet Keystone janë vlerësime të lëndës, të cilat janë konceptuar për vlerësimin e përvetësimit të përmbajtjes mësimore. Duke filluar me klasën e vitit 2017 (klasa e 9<sup>të</sup> aktuale), nxënësit duhet të demonstrojnë aftësi në Provimet Keystone në lëndët Algjebra I, Letërsi dhe Biologji, në mënyrë që të diplomohen. Në këtë rast, këto kërkesa të reja do të aplikohen edhe për diplomimin nga shkolla e mesme të fëmijës tuaj.

Nxënësit e përfshirë në klasat që lidhen me Provimet Keystone (Algjebra I, Anglisht 2, Biologji) duhet të kalojnë Provimet Keystone përkatëse (Algjebra I, Letërsi, Biologji), në përfundim të lëndës.

Meqënëse shumica e nxënësve të klasave të 9<sup>ta</sup> janë të regjistruar aktualisht në klasat e Algjebërës I, ata do të bëjnë Provimin Keystone për Algjebra I, këtë vit. Vitet e ardhëshme, pas plotësimit të klasave të Biologjisë dhe Anglisht 2, ata do të bëjnë Provimet Keystone në Biologji dhe Letërsi.

Në rast se nxënësit nuk e kalojnë Provimin Keystone me herën e parë, ata do të kenë mundësi të tjera për marrjen e provimit, përpara se të diplomohen. Megjithatë, **duhet** që deri në Qershor 2017, nxënësit t'i kenë kaluar të tre Provimet Keystone, që të diplomohen nga shkolla e mesme.

Për pyetje që lidhen me Provimet Keystone, ju lutemi kontaktoni [assessment@philasd.org](mailto:assessment@philasd.org).